



Prishtinë: 11.11.2016
Kodi i ZRRE-së: V_862_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1533_10_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **27.10.2016**.

në seancën e mbajtur më datë **11.11.2016**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit M. D. me shifër DMI - 9044883 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1533_10_16** i datës 10.10.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 27.10.2016 ka pranuar ankesën e konsumatorit M. D. me të cilën ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, i cili ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të shqyrtoj ankesën që ka të bëjë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se kërkon ekspertizë për kohën e keqpërdorimit të energjisë elektrike, të bëhet një analizë rreth shpenzimeve të energjisë elektrike deri në periudhën kontestuese si dhe ka theksuar se asnjëherë nuk kam manipuluar me njëhisorin elektrik.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 06.10.2016 ka pranuar ankesën e konsumatorit së bashku me vendimin me numër C.nr.74/2015 i datës 20.07.2016 të nxjerrë nga Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike nga konsumatori M. D.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj në seancën e mbajtur me datë 20.07.2016 në çështjen juridike të paditësit M. D. kundër të paditurës KESCO, në Prishtinë për ngarkesë të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, me Aktvendimin numër C.nr.74/2015 ka shpall veten jokompetente në pikëpamje lëndore si dhe duke e hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësit kundër të paditurës KESCO.



Gjykata pasi hedhi padinë e paditësit si të palejuar vlerësoi se padia e paditësit është e parakohshme përkatësisht e palejuar për faktin se sipas dispozitave ligjore në Ligjin e Rregullatorit për Energji përkatësisht neni 16 par. 1 pika 3 ku parasheh që Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetencat për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë. Gjithashtu gjykata i është referuar edhe dispozitës së nenit 25 par 1 të njëjtit ligj ZRRE ka kompetencë të nxjerr vendime për zgjidhjen e kontesteve sipas nenit 16 të këtij ligji.

Gjykata gjithashtu në vendimin e saj ka konstatuar se sipas dispozitës së nenit 25 par. 3 si dhe dispozitës së nenit 43 të Ligjit për rregullatorin e energjisë si dhe në pajtim me ligjin për procedurën administrative konsumatorët apo të licencuarit mund të fillojë procedurë administrative në gjykatën kompetente.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 11.11.2016 ka analizuar ankesën me të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga ana e konsumatorit M. D. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se ankesa e konsumatorit ka të bëjë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar se vendimi i DMK-së numër **ZRRE/DMK_V_1533_10_16** i datës 10.10.2016 është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla në fuqi, pasi që neni 61 i Ligjit të Energjisë Elektrike LIGJI Nr. 05/L – 085 si dhe dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin e XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale Kundër Shërbimeve Komunale i ndalon ZRRE-së që të shqyrtoj ankesat që kanë elemente të veprës penale apo shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi gjithashtu ka konstatuar se edhe në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës kapitulli XXVI, përkatësisht nenet 319, 320, 321, 322, 323 dhe 324 i definojnë saktë veprat penale kundër shërbimeve komunale ku ndër to parashihet edhe vjedhja e energjisë elektrike, andaj mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 4 paragrafi 2 të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë është vendosur se Zyra e Rregullatorit për Energji nuk ka kompetencë që të merret me shqyrtimin e ankesave që kanë elemente të veprës penale, vjedhje e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar se vendimi i Departamentit për konsumator në ZRRE, ka të bëjë vetëm me kompetencë lëndore që do të thotë se në këtë vendim nuk është shqyrtuar çështja meritore, gjithashtu në vendim nuk është konstatuar se konsumatori a është kryes i veprës penale, vjedhje e energjisë elektrike apo jo, por vetëm se në bazë të provave të vërtetuara ka konstatuar se ZRRE nuk ka mandat ligjor për shqyrtimin e kësaj anekese.

Lidhur me pikën kontestuese të theksuar konsumatori në ankesë se ZRRE të bëjë një ekspertizë të njehsorit elektrik se i njëjti a është keqpërdorur, Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se meqenëse natyra e ankesës shfrytëzim i paautorizuar nuk është kompetencë ligjore e ZRRE-së për shqyrtim një kërkesë e tillë nuk mund të adresohet për faktin se organi i cili duhet të shqyrtoj ankesën ka autoritetin të kërkoj që të bëhet një ekspertizë në rast se e sheh të nevojshme.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka konstatuar se DMK në vendimin e saj me të drejtë i është referuar dispozitës së nenit 18 të Ligjit për Procedurën Administrative Ligji Nr. 02/L-28 për shkak të dërgimit të kërkesës te një organ që nuk ka kompetencë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit M. D,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.